



Njësia i Prokurimit

Istog: datë, 29.06.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Istogut, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesave për ri-shqyrtim të datave 22, 26.06.2020 të parashtruar nga Operatoret Ekonomik Menti shpk, Lurn shpk, Guri Group shpk dhe Alfa-i shpk lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:

“LOTO1 - BETONIMI I KANALIT VERSHUES TE RUDESHIT NE VRELLE.

LOTO2 - BETONIMI I KANALIT TE UJITJES VRELLE-LUBOZHDE.

LOTO3 - BETONIMI I KANALIT TE UJITJES LAGJA KABASHI-BAJRAMAJ GURRAKOC.

”, me Nr. të Prok: **633-20-1415-5-2-1** nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohen si te pabazuara kërkesat për ri-shqyrtim të Operatoreve Ekonomik Menti shpk, Lurn shpk, Guri Group shpk dhe Alfa-i shpk të dt. 22, 26.06.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjale me Nr. **633-20-1415-5-2-1** Nr. Brendshëm **633-020-016-521**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK –së, të datës 19.06.2020 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. **Vërtetohet** Njoftimi mbi vendimin e AK të publikuar me datë: 19.06.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatoret Ekonomik te cilet kane bere kerkese per ri-shqyrtim, jane te njoftuar permes letrave standarde si pjese perberese e Njoftimit mbi vendimin e AK-se, te dates 19.06.2020 per shkaqet pse jane operatore te eliminuar apo te pasuksesshem.

Sa i perket operatorit ekonomik Alfa-i, komisioni vlersues gjate vlersimit ka bere perlllogaritjen e gjatesise se projektit me cmimet e ofruara nga operatoret konkurues dhe oferta e kompanise Alfa-i eshte oferta me cmimin me te larte konkurues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit